



Planuar / Doretuar Priljena / Predato Received / Delivery	19. 05 2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	2944/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.280/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegj: për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.280/2022 të datës 24.03.2022 të ankuesit me adresë banimi:

kundër Vendimit të Komisionit të Pranimit të Komunës së Prishtinës i datës 21.03.2022, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar, ankesa A.nr.280/2022 e datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës më datë 28.01.2022 ka shpallur konkursin për pozitën “Specialistë të Burimeve Njerëzore”-“Zyrtar i Lartë i Personelit”, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi I pakënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit me datë 18.03.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit, ndërsa Komisioni i Pranimit me datë 21.03.2022 ka nxjerrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 18.03.2022.

Ankuesi i pakënaqur i pakënaqur me Vendimin e datës 21.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Prishtinës, ka parashtruar ankesë përmes e-maili me datë 23.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 24.03.2022 me numër protokoll: 1560/2022 me pretendimet ankimore që procedura e rekrutimit për pozitën “Specialistë të Burimeve Njerëzore” e zhvilluar nga Komuna e Prishtinës është zhvilluar në kushte të pabarabarta pasi që Komisioni i Pranimit nuk e ka vlerësuar jetëshkrimin e ankuesit maksimalisht me 20 pikë me kërkesën që aplikacioni i tij të shpallet fitues pasi që i ka plotësuar kriteret e parapara, sikurse kanë qenë kualifikimi dhe përvoja e punës, ndërsa Këshilli të vendos së ankuesi duhet të jetë kandidati i përzgjedhur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 31.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Komuna e Prishtinës me datë 08.04.2022 ka dërguar përgjigje në ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër prot:2126/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1560/2022 e datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën e ankuesit të datës 31.01.2013; Diplomën e ankuesit të datës 18.07.2018; Çertifikatën e ankuesit të datës 15.02.2011; Çertifikatën e ankuesit të datës 14.12.2018; Çertifikatën e ankuesit periudhës nëntor 2020; Vërtetimin 15.12.2016; Dëshminë e punës të lëshuar nga N.T.P “Elsa 2”; Çertifikatën e ankuesit të datës 08.01.2018; Vendimin e datës 03.01.2018 të kryetarit të Komunës së Kaçanikut; Vendimin e datës 11.01.2022 të kryetarit të Komunës së Kaçanikut; Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 06.12.2019; Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 22.10.2021; Ankeën e ankuesit të datës 18.03.2022 parashtruar në Komisionin e Pranimit të Komunës së Prishtinës; Vendimin e Komisionit të Pranimit të Komunës së Prishtinës i datës 21.03.2022; E-mailin e datës 23.03.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2022; Përgjigjen në kërkesë dërguar nga Komuna e Prishtinës me provat e bashkangjitura prej 164 faqesh; Konkursin e datës 28.01.2022; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 23.03.2022; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 25.03.2022; Aplikacionin e kandidatit më të suksesshëm më dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Testin me shkrim të ankuesit; Vendimin e këshillit me numër:38/2022 të datës 05.05.2022; E-mailin e datës 04.05.2022 me numër prot:2595/2022 dërguar nga për Këshillin me shkresat e bashkangjitura prej pesë (5) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë së shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me procedurën e rekrutimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”.*

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi ka qenë pjesë e procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Lartë i Personelit” të shpallur nga Komuna e Prishtinës, ndërsa i njëjti i pakënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit, ku i njëjti komision përmes vendimit të datës 21.03.2022 e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi vlerësimin paraprak të jetëshkrimit, ndërsa ankuesi kundër vendimit të Komisionit të Pranimit të datës 21.03.2022 ka parashtruar ankesë me datë 24.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje”* ka konstatuar se



ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 24.03.2022 është e palejueshme pasi që i njëjti nuk ka parashtruar ankesë kundër aktit përfundimtar, respektivisht Njoftimit të datës 25.03.2022 në të cilin konstatohet se kandidati është përzgjedhur i kandidati më i suksesshëm, siç përcaktohet me *paragrafin 6 të nenit 25 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës*: “Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje” ndërlidhur me paragrafin 1 dhe 5 të nenit 25 të së njëjtës rregullore ku parashihet se: “1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj; 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”.

Po ashtu, Kolegji njëzëri konstaton se meqenëse ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se i njëjti pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër njoftimit të datës 25.03.2022, ankesa e ankuesit është e palejueshme ngase vlerësimi i jetëshkrimit nuk llogaritet akt përfundimtar i përfundimit të procedurës së rekrutimit në kuptim të nenit 31 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankuesit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe” ankesa e ankuesit vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.280/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës
- Arkivit të KPMSHCK-së

